



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.984/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbare të kreditorit Agro Stubline d.o.o, me nr. Biznesi PIB 112345991 me seli në Serbi, ndaj debitorit NTP Nushi me numër identifikues 811055806 me seli në Ferizaj, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1089/22 datës 01.03.2024, me datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Agro Stubline d.o.o, me nr. Biznesi PIB 112345991 me seli në Serbi, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1089/22 i datës 01.03.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1089/22 dt.01.03.2024, ka Pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit NTP Nushi me numër identifikues 811055806 me seli në Ferizaj, dhe ka Anuluar urdhrin përmbare P.nr.419/22 dt.24.05.2022, i lejuar nga Përmbaresi Privat Kushtrim Musa

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, për shkak të shkeljeve thelbësore te dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të se drejtës, materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne shkallë te parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në përgjigjen në ankesë, debitori deklaroi se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe drejt ka aplikuar të drejtën materiale, i propozon gjykatës që ta refuzoj ankesën e kreditorit.

Dhomat e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së e lidhur me nenin 17 te Ligjit për Procedurën Përmbare (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Agro Stubline d.o.o, me nr. Biznesi PIB 112345991 me seli në Serbi, me datën 24.05.2022, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit NTP Nushi nga fshati Dardani p.n. Ferizaj, në bazë të faturës si dokument i besueshëm.

Përmbaruesi Privat Kushtrim Musa, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin përmbarimor P.nr.419/22 dt.24.05.2022, me të cilin e ka detyruar debitorin që mbi bazën e faturave 20/21 dt.16.10.2021, 21/21 dt.23.10.2021, 25/21 dt.18.11.2021, 27/21 dt.02.12.2021, 28/21 dt.07.12.2021, 30/21 dt.14.12.2021 dhe 32/21 dt.21.12.2021, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t,ia paguaj kreditorit shumën prej 80,700.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se urdhri përmbarimor është i parregullt dhe i paligjshëm, se faturat nuk i plotësojnë kushtet për përmbarim. Kreditori duke keqpërdor besimin ka iniciuar procedurë përmbarimore mbi bazën e faturave të cilat janë të përmbushura me para në dorë. Propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbarimor ta anuloi.

Ndaj prapësimin të debitorit, kreditori ka ushtruar përgjigje, me arsyetimin se procedura është iniciuar në bazë të faturave të cilat i plotësojnë kushtet ligjore për të shërbyer si dokumente të besueshme dhe se të njëjtat janë dorëzuar në origjinalë. Debitori ka pranuar mallrat nga kreditori mirëpo prapësimin e ka paraqitur vetëm për të shtyrë procedurën përmbarimore. Faturat janë pranuar dhe vulosur nga ana e debitorit ndërsa pretendimet se detyrimet është përmbushur me para në dorë është tërësisht i pabazuar, andaj propozon që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.1089/22 dt.01.03.2024, me të cilin ka vendosur decidivishtsi në dispozitiv të aktvendimit. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se propozimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet. Gjykata ka gjetur se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe të përshtatshme për përmbarim, ngase në fatura mungon debitori i përmbarimit, përkatësisht nuk është evidentuar saktë debitori për mes numrit biznesit, element ky që kërkohet sipas nenit 29.3 të LPP-së. Në mungesë të përcaktimit të saktë të debitorit përmes numrit identifikues apo të biznesit, fatura nuk mund ta ketë cilësinë e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së. Veç të metave të lartcekura gjykata gjen se zbatimi i dokumentit të besueshëm të lëshuar nga një subjekt i vendit të huaj sikurse në rastin konkret duhet ti nënshtrohet nenit 11 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Dhomat e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore,

Aktvendimi i atakuar rezulton të mos jetë përfshirë as me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së dhe nuk ka as shkelje lidhur me zbatimin e të drejtës materiale për të cilat Gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Po ashtu aktvendimi i atakuar nga gjykata e shkallës së parë është marrë pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të cilat kanë mbështetje në shkresat e lëndës dhe në ligj.

Ne lidhje me këtë çështje kjo gjykatë analizon propozimin për përmbarim të kreditorit dhe pranon në tërësi përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, sepse është fakt se faturat e lëshuara nga kreditori, si dokumente të besueshme, mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor, nuk paraqesin të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e debitorit. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Edhe Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret faturat e lëshuara nga kreditori, nuk plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm nga neni 29 pika 1.2 dhe 21 të LPP, dhe si rezultat i kësaj rrjedh se propozimi për përmbarim i kreditorit është ushtruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Së këndejmi, zbatimi i dokumentit të besueshëm të një vendi tjetër nga Republika e Kosovës i nënshtrohet aplikimit të dispozitës së nenit 11 të LPP-së, e cila përcakton se: *“Përmbarimi i dokumentit të huaj përmbarimor do të caktohet dhe zbatohet sipas këtij ligji, nëse dokumenti përmbarimor i huaj i plotëson kushtet e parapara me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare për praninë dhe përmbarim”*. Në rastin konkret, shihet qartë se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit mbështetet në fatura të lëshuara nga subjekti juridik i shtetit të huaj, që nënkupton se detyrimi i referohet legjislacionit të vendit të huaj.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, ka analizuar pretendimet e kreditorit por konsideron se të njëjtat nuk janë relevante për një vendosje ndryshe nga çka vendosur gjykata e shkallës së parë, ashtu që vendosi që ti refuzoj si të pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 par.1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.984/24 me datë 04.06.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha